

**VENDIM**  
**Nr.803, datë 4.6.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,  
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,  
KOMUNA SHËNKOLL, TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Shënkoll, të qarkut të Lezhës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 11 (njëmbëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Shënkoll për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**FORMULARË PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE**

( Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU

Komuna: Shënkoll

| Nr. Rend. | Nr. sipas VKM | Emërtesa e ekonomisë e pyjore dhe kullosore (EPK), shtrirja gjeografike e EPK | Emërtesa e ngastrës, vendndhja (sipas emërtesës popullore) | Numri i ngastrës | Destinacioni      | Sipërfaqja në ha. | Funksioni për të cilin përdoret pronë | Institucioni, enti me përgjegjësi administrative | Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta) |
|-----------|---------------|-------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|------------------|-------------------|-------------------|---------------------------------------|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|----------------------------------------|
| 1         | 2             | 3                                                                             | 4                                                          | 5                | 6                 | 7                 | 8                                     | 9                                                | 10                                                         | 11                                     |
| 1         | 30            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Hidrovori Tale                                             | 31               | Sip. inproduktive | 2.75              |                                       | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 2         | 31            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Patoku Bregu i Matit                                       | 34               | Pyll mbrojtës     | 5.75              | Mbrojtje Toke                         | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 3         | 32            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Blloku Gjon Markaj                                         | 35 a             | Pyll mbrojtës     | 2.8               | Mbrojtje toke                         | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 4         | 33            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Blloku Gjon Markaj                                         | 35 b             | Pyll Mbrojtës     | 3                 | Mbrojtje toke                         | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 5         | 34            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Blloku Shtëpia e Mark Zefit                                | 36               | Pyll mbrojtës     | 9.4               | Mbrojtje toke                         | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 6         | 35            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Blloku Peneleve Tale                                       | 37 a             | Sip. pyjore       | 7.1               | Sip. pyjore                           | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 7         | 36            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Blloku Peneleve Tale                                       | 37 b             | Sip. Pyjore       | 1.8               | Sip. pyjore                           | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 8         | 37            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Blloku Shënkoll                                            | 42               | Bimesi            | 10                | Pr.                                   | D.P.P.K                                          | D.SH.P                                                     | Pyll shtetëror                         |
|           |               |                                                                               |                                                            |                  | Et.-Vajore        |                   | te dyta                               |                                                  | Lezhe                                                      |                                        |
| 9         | 38            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Bregdet-Tale                                               | 47 a             | Ranishte          | 63.5              | Gjueti                                | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 10        | 39            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Bregdet-Tale                                               | 47 b             | Legatine          | 202.2             | Gjueti                                | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |
| 11        | 40            | Ek.Pyj."Shengjin-Tele"                                                        | Bregdet-Tale                                               | 47 c             | Sip. Ujore        |                   | Peshkim                               | D.P.P.K                                          | D.SH.P Lezhe                                               | Pyll shtetëror                         |

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Shënkoll

Lidhja nr.1

| <b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b> | <b>Lloji i transferimit</b> |
|---------------------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------|
| 30, 35 – 37                                             | Sipërfaqe pyjore, inproduktive      | Në pronesi                  |
| 38-40                                                   | Ligatinë, ranishte, sipërfaqe ujore | Në pronesi                  |
| 31 - 34                                                 | Pyll mbrojtës                       | Në pronesi                  |
|                                                         |                                     |                             |